VENDIM
Nr. 180, datë 30.3.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E PËRGATITJES SË SHESHEVE TË NDËRTIMIT NË BASHKINË KRUJË

(ndryshuar me vendimin nr. 692, datë 6.12.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 115 965 523 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet e tre) lekësh pa TVSH, për financimin e shembjeve të njësive individuale të banimit të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre në Bashkinë Krujë.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, për financimin e shembjeve të njësive individuale të banimit të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre në Bashkinë Krujë, në masën 23 193 104 (njëzet e tre milionë e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e katër) lekë pa TVSH, që përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, për financimin e shembjeve të njësive individuale të banimit të pabanueshme, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe transportimin e materialeve të dala nga shembja e tyre në Bashkinë Krujë, në masën 58 482 812 (pesëdhjetë e tetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, që përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj